

## Karta e-Dytë e apostollit Pavël mbë Timothenë.

### Krye 1.

- 1 Pavli, apostoll i Jisu Krishtit me anë të dashurimit të Perëndisë, pas të-zotuarit të 2 jetësë që është mbë Jisu Krishtinë, Mbë Timothenë, birin' e-dashurë, *qoftë* hir, përdëllim, paqtim prej Perëndisë, Atit, edhe prej Jisu Krishtit, Zotit t' ënë.
- 3 I falem ndersë Perëndisë, të-cilin' e lus që nga prindërit' e mi me ndërgegje të-kthjellëtë, se pa pushim të kujtonj ndë të-falurat të mia nat' e ditë, Edhe se, kur kujtonj lot' e tu, kam mall të të shoh, që të mbushem 5 me gëzim; Sepse bje ndër mëntt besënë t'ën-de pa ipokrisi që është te ti, e-cila më për-

- para ndënjti te jot' gjyshe Lloidhë, edhe te jot' ëmë Evnikë; edhe më është mbushurë mëndja *se ka ndënjurë* edhe te ti.
- 6 Për këtë ngajë të përmënt ty të ngjallç përsëri dhurëtin' e Perëndisë, e-cila është te ti me anë të të-vënit të duarvet të mia mbi 7 ty. Sepse Perëndia s'na ka dhënë frymë frike, po fuqie e dashurie e urtësisë.
  - 8 Mos kij turp pra për dëshmimn' e Zotit t'ënë, edhe për mua të lidhurin' e ati; po hiq keq bashkë me mua për ungjillinë pas fuqis' së Perëndisë: I-cili na shpëtoj, edhe na thërriti me të-thërtiturë të-shënjtëruarë, jo pas punëravet t'ona, po pas vendimit të ti, edhe pas hirit që na udha mbë Jisu Krishtinë që 10 përpara kohëravet të-përjetëshme, Edhe që uçfaq ndashti me anë të të-dukurit të-shpëtimtarit t'ënë Jisu Krisht, i-cili prishi vdekjenë, edhe nxori ndë dritë jetën' edhe pavdekjenë 11 me anë të ungjillit. Për këtë uvushë unë lëçitës edhe apostoll edhe mësonjës i kombevet; Për të-cilënë punë edhe pësonj këto; po nukë kam turp; sepse e di kujt i kam besuarë, edhe më është mbushurë mëndja, se ay munt të ruanjë ndorjenë t'ime gjer mb' atë ditë.
  - 13 Ruaj formën' e fjalëvet të-shëndosha, që dëgjove prej meje, me besë e me dashuri që 14 është mbë Jisu Krishtinë. Ndorjenë e-mirë ruaj-e me anë të Frymës' së-Shënjtëruarë që rri ndër ne.

15 *Ti* e di këtë, se gjith ata që janë nd' Asi  
 më kthyenë krahëtë, prej të-cilëvet është Fy-  
 16 gjelli edhe Hermogjeni. Zoti dhëntë përdë-  
 llim ndë shtëpit të Onisiforit; sepse shumë  
 herë më dha zëmërë, edhe s'pat turp prej he-  
 17 kuravet të mia, Po kur erdhi ndë Romë, më  
 18 kërkoi me shumë nxitim, edhe më gjeti. Zoti  
 i dhëntë ati të gjenjë përdëllim nga Zoti nd'  
 atë ditë. Edhe sa më shërbeu nd' Efesë, ti i  
 di më mirë.

## Krye 2.

1 *Ti* pra, o biri im, forcuhu ndë hirt që  
 2 është mbë Jisu Krishtinë; Edhe sa dëgjove  
 prej meje me shumë dëshmitarë, ep-i ndër  
 duar të njerësve besëtarë, të-cilëtë dotë  
 3 jenë të-zottë të mësonjënë edhe të-tjerë. *Ti*  
 pra vuaj posi ushtëtar i-mirë i Jisu Krish-  
 4 tit. Sepse asndonjë që vete ushtëtar nukë  
 ngatëronetë me punërat e të-rrojturit, që t'i  
 5 pëlqenjë ati që e mori ushtëtar. Po edhe ndë  
 luftoftë ndonjë, nukë kurorëzonetë, ndë mos  
 6 luftoftë pas nomit. Bujku që mundonetë du-  
 7 hetë i-parë të-marrë pjesë nga pemëtë. Ku-  
 pëto ato që them; edhe Zoti të dhëntë mënt  
 8 mbë të-gjitha. Ki ndër mënt Jisu Krishtinë  
 nga far' e Dhavidhit që është ngjallurë prej  
 9 së-vdekurish, pas ungjillit t'im; Për të-cilinë  
 vuanj gjer mbë të-lidhura posi keq-bërës;  
 10 po fjal' e Perëndisë nukë lidhetë. Përandaj

të-gjitha i duronj për të-sgjedhuritë, që të  
 gjenjën' edhe ata shpëtimnë që është mbë  
 Jisu Krishtinë, bashkë me lavdi të-përjetë-  
 11 shme. Për të zënë besë është *këjo* fjalë; se-  
 pse ndë vdiqmë bashkë *me Krishtinë*, kemi  
 12 edhe për të rruarë baskë *me atë*; Ndë durof-  
 shimë, kemi edhe për të mbretëruarë bashkë  
*me atë*; ndë *e* mohofshimë, edhe ay dotë na  
 13 mohonjë; Ndë dalçimë të-pabesë, ay mbetetë-  
 besëtar; nukë munt të mohonjë vetëhen'e ti.  
 14 Këto u'a bjerë ndër mënt, dyke porosi-  
 turë ata përpara Zotit, të mos hahenë me  
 fjalë, *e-cila gjë s'është* për asgjë e-dobishi-  
 me, *po* për prishje t'atyre që dëgjonjënë.  
 15 Kujdesu t'a nxjerç vetëhenë t' ende të-pro-  
 vuarë përpara Perëndisë, punëtar faqe-bar-  
 dhë, që pret drejtë fjalën' e së-vërtetësë.  
 16 Edhe largohu nga të-ndyratë fjalë të-kota;  
 17 sepse stonjënë më shumë pabesëri; Edhe  
 fjal' e atyreve ka për të ngrënë posi qimezë;  
 18 nga këta është Hymenaj edhe Filiiti, Të-  
 cilëtë duallë jashtë udhës' së të-vërtetësë.  
 dyke thënë, se ndashti ubë të-ngjalluritë; edhe  
 përmbysnjënë besën' e cave.  
 19 Po themeli' e-fortë e Perëndisë qëndron,  
 edhe ka këtë vulë: Zoti njuh ata që janë të-  
 titë; edhe, Letë largonetë nga shtrëmbëria  
 kushdo që zë n' gojë emërin' e Krishtit.  
 20 Edhe ndë *një* shtëpi të-madhe nukë ka  
 vetëm' enë të-arta e të-ergjënta, po edhe të-

- drunjta e të-ballta; e ca *duhenë* për *punë* të-nderçime, e ca për *punë* te-panderçime. Ndë qëroftë pra ndonjë vetëhen' e ti nga këto, dotë jetë enë për nder, e-shënjtëruarë, edhe e-vëjyerë per të zonë, e-bërë gati për çdo punë të-mirë.
- 22 Edhe largohu nga dëshërimet' e djalërisë; edhe bjer'i pas drëjterisë, besësë, dashurisë, paqtimt bashkë me ata që thërresënë mbë
- 23 Zotinë prej zëmëre së-kthjellëtë. Edhe hiq dorë nga të-marrat'e të-padiçimetë të-ngrëna me fjalë, dyke diturë se *ato* pjellënë të-zëna.
- 24 Edhe shërbëtor' i Zotit nukë duhetë të zihetë, po të jet'i-butë mbë të-gjithë, i-zoti të mësonjë *njerëzitë*, *njeri* që duron të-ligënë,
- 25 *Njeri* që mëson me butësirë ata që kanë mendime te-kundrejtë, edhe *kështu* mbase u ep atyreve. Perëndia pendim, që të njohënë të-vërtetënë, Edhe të shpëtonjenë nga laku i djallit, prej të-cilit janë zënë robër ndë dashurimt t' ati.

### Krye 3.

- 1 Edhe dij-e këtë, se ndë ditt të-pastajme
- 2 kanë për të ardhurë kohëra të-këqia; Sepse njerëzitë dotë jenë vetëdashës, ergëntdashës, krye-lartë, madhështorë, vllasfimitarë, të-pabindurë nde prindërit, mos-mirënjohës, të-paudhë, Të-padhëmçurë, të-papaqtuarshim, kallëzimtarë, të-pambajturë, të-egërë, t' atillë

- 4 që s' duanë të-mirënë, Trathëtorë, gojë-sbrazëtë, të-fryjturë, kënaqëdashës me tepërë
- 5 se perëndidashës, Të-cilëtë kanë të-dukurë bese së-mirë, po fuqin' e asaj e kanë mohuarë; edhe nga këta largohu. Sepse prej këtyrë jan' ata që hynjënë ndëpër shtëpirat, edhe skllavosnjënë gratë që janë ngarkuarë me
- 7 faje, e hiqënë prej çdo farë dëshërimesh, Të-cilatë gjithënjë mësonenë, e kurrë s' munt të
- 8 vinjënë ndë të-njohurit të së-vërtetësë. Edhe sikundrë Janniu e Jambriu ndejtnë kundrë Moisiut, kështu edhe këta rrinë kundrë së-vërtetësë, njerës të-prishurë nga mëndja, të-pa
- 9 provuarshim ndë besët. Po s'kanë për të mbrothësuarë më tepërë; sepse marrësia e atyre dotë çfaqetë mbë të-gjithë, sikundrë *uçfaq* edhe e atyreve.
- 10 Po ti i re prapa mësimt t' im, të-sjellavet, qëllimit, besësë, zëmëres' së-gjerë, dashurisë, durimit, Të-ndjekuravet, të-pësuaravet, që më gjajtnë ndë Antiohi, ndë Ikoni, nde Lystrë; ç'fare të-ndjekurash hoqa? edhe Zoti
- 12 më shpëtoj nga të-gjitha. Po edhe gjithë sa duanë të rronjënë me besë të-mirë mbë Jisu
- 13 Krishtinë dotë ndiqenë. Po njerëzit' e-liq e gënjeshtarë dotë venë mbarë mbë më të-ligënë, dyke gënjyerë *të-tjerë* e dyke gënjyerë vetëhenë.
- 14 Po ti qëndro mb' ato që nxure e uvërte-
- 15 tove, dyke diturë prej cilit i ke nxënë; Edhe

se që nga foshnjëria i di shkronjat' e-shënjtëruara, të-cilatë munt të të bënë të-diturë për shpëtim me anë të besësë që është  
 16 mbë Jisu Krishtinë. Gjithë shkronja është prej Frymës' së Perëndisë, edhe e-dobishime për mësim, për qërtim, për të-ndrequrë, për  
 17 arrësim që është me drejtëri; Që të jet' i-sosurë njeriu i Perëndisë, i-bërë gati për çdo punë të-mirë.

## Krye 4.

- 1 Të urdhëronj pra unë përpara Perëndisë edhe Zotit Jisu Krisht, që ka për të gjykuarë të-gjall' e të-vdekurë ndë të-dukurit të ti edhe
- 2 ndë mbretërit të ti; Lëçit fjalënë; qëndro me kohë e pa kohë; qërto, bjerë ndër sy, ngut me çdo farë zëmëre së-gjerë e me mësim.
- 3 Sepse ka për të ardhurë kohë, kur nukë dotë duronjë në mësim' e-shëndoshë, po dotë mbledhënë grumbullë për anë vetëhes' së tyre mësonjës pas dëshërimevet të tyre, për të
- 4 gudulisurë veshëtë; Edhe nga e-vërteta dot' i largonjë në veshëtë, edhe dotë kthenenë të
- 5 *venë* pas përrallavet. Po ti rri sguarë mbë të-gjitha, vuaj, bëj punë ungjilltari, shërbesënë t' ende bëj-e të-mbaruarë.
- 6 Sepse unë ndashti jam dyke derdhurë gjakunë, edhe koha e të-ikurit t'im arriti.
- 7 Luftën' e-mirë luftova, udhën' e mbarova, be-
- 8 sën' e ruajta; Paskërajthi më mbetetë kurora

- e drejtërisë, të-cilënë dotë m'a apë Zoti nd' atë ditë, i-drejti gjykatës; edhe jo vetëmë mua, po edhe gjith' atyreve që duanë të-dukurit' e ati.
- 9 Përpiqu të vish çpejt tek unë. (10) Sepse Dhimaj më la, sepse deshi këtë botë, edhe vate ndë Thessallonikë; Krisku ndë Gallati;
  - 11 Titua ndë Dhallmati; Vetëmë Llukaj është bashkë me mua. Markunë merr-e me vetëhe edhe bjer'-e bashkë me ty; sepse më është i-
  - 12 vëjyerë ndë punët. Edhe Tihikon' e dërgova ndë Efesë.
  - 13 Kur të vish, bjerë gunënë që lashë ndë Troadhë për anë Karpit, edhe libratë, po më fort memvranatë.
  - 14 Aleksandër ramtori shumë të-liga më bëri;
  - 15 Zoti ja çpagoftë pas punëravet t'ati; Prej të-cilit edhe ti ruhu; sepse shumë rri kundër fjalëvet t'ona.
  - 16 Ndë të-mbrojturit t'im të-parë asndonjë nukë erdhi bashkë me mua, po të-gjithë më
  - 17 lanë; (mos u unumëroftë atyre *për faj*;) Po Zoti më ndënji për anë, edhe më dha fuqi që me anë t'ime të mbushëtë të-lëçituritë, edhe të dëgjonjë në gjithë kombëtë; edhe shpëtova
  - 18 nga goj' e leonit. Edhe Zoti dotë më shpëtounjë nga çdo pun' e-keqe, edhe dotë më ruanjë për mbretërin' e ti qiellore; mbë të-cilënë *qoftë* lavdia ndë jetët të jetëvet. Amin.
  - 19 I ufal me shëndet Priskësë edhe Ahillit,

- 20 edhe shtëpis' s' Onisiforit. Erasti mbeti ndë Korinthë; edhe Trofimnë e lëshë të-sëmurë
- 21 ndë Militë. Përpiqu të vinjë përpara dimërit. Të faletë me shëndet Efvuli, edhe Pudhi, edhe Lini, edhe Kllavdhia, edhe gjithë vëllezëritë.
- 22 Zoti Jisu Krisht *qoftë* bashkë me frymënë t'ënde.

Hiri *qoftë* bashkë me ju. Amin.

---